

FJALA E DEPUTETES GRETA BARDELI

E HËNË 11 PRILL 2022

Të nderuar bashkëqytetarë,

Kolegë parlamentarë,

Dy javë më parë Shkodra u zgjua nga dy shpërthime të forta tritolli në qendër të saj, të cilat tronditën fëmijë, të rinj, gra e burra të moshuar, në një zonë që zakonisht është destinacion për turizmin kombëtar dhe ndërkombëtar, aty ku ndodhen disa nga institucionet qendrore të qarkut, monumente kulture, biznese e banesa, të cilat patën dëmtime serioze, por, falë Zotit, nuk pati viktima. Si deputete që jetoj në atë qytet, bashkë me të gjithë qytetarët, dënova ashpër aktin e rëndë, cenimin e sigurisë dhe të rendit publik, duke u kërkuar institucioneve ligjzbatuese vënien e autorëve para drejtësisë. Sot u kërkoj nga ky parlament ministrin të Brendshëm dhe drejtorin të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit të kryejnë detyrën, të veprojnë shpejt dhe të mos heshtin.

Gjithashtu, i kërkoj Komisionit të Sigurisë ta ndjekë këtë çështje. Shkodra nuk mund të vazhdojë të jetë skenë e krimit të organizuar, ushqim për bandat kriminale. Qytetarët e Shkodrës nuk e meritojnë këtë. Kjo qeveri nuk hesht kur vjen puna të legalizimi i kanabisit. Një qytetar i Shkodrës me profesion pedagog së bashku me bashkëshorten e tij po pedagogje në universitet po më tregonin një ditë se prej disa muajsh po përgatiteshin të iknin nga vendi (ata kanë dy fëmijë, 10 vjeç dhe 14 vjeç) dhe po kërkonin punë diku në Gjermani, çfarëdolloj të ishte, qoftë edhe në pastrim. Ata besojnë se për fëmijët e tyre e ardhmja në emigrim do të jetë shumë më ndryshe dhe e garantuar, larg një vendi të pasigurt, një universiteti, të cilit po i pakësohen studentët për shkak të emigracionit, shkollave ku rreth e rrotull rrinë si hije shitësit e kanabisit dhe drogës. Sot ata dhe shumë bashkëqytetarë të mi janë më të vendosur se kurrë për ta braktisur vendin.

Përtej varfërisë, pabarazisë sociale, korrupsionit të zyrtarëve, mungesës së sigurisë, tashmë i shtohet edhe çmenduria e qeverisë për legalizimin e kanabisit. Cili është grupi i interesit që mezi pret kultivimin zyrtar të kanabisit? Pa dyshim, janë të interesuar vetëm ata që nxjerrin fitime nga ai lloj kanabisi që mbillet sot. Pra, rrjetet kriminale dhe politikanët e lidhur me ta janë pushtetarët përfitues për shkak të ndikimit që ka paraja e zezë në proceset zgjedhore. Në maj të vitit 2020 Kryeministri deklaroi publikisht se qeveria e tij po punonte prej një viti, pra prej 2019-s, për një projektligj për kanabisin. Opozita e ka denoncuar me forcë këtë projekt kriminal. Edi Rama dhe qeveria e tij kanë vlarë shpresën e të rinjve tanë në emër të popullit. Projekti i tij që në vitin 213 për kanabizimin e vendit është i faktuar, gjithashtu, nga shumë raporte ndërkombëtare.

Grupet kriminale të lidhura me qeverinë u vunë në përgjim dhe përndjekje nga partnerët ndërkombëtarë. Grupi kryesor kriminal në shërbim të ministrit të Brendshëm përfundoi në pranga falë partnerëve ndërkombëtarë, ndërsa një rrjet i tërë të inkriminuarish në radhët e policisë dhe shtetit ishin në shërbim të tyre.

Natyrisht, çështja e rritjes së pensioneve, zbutja e varfërisë dhe papunësia janë probleme të radhës së dytë dhe të tretë sot, kurse kanabizimi është prioritet kombëtar për qeverinë. Me këtë akt ne nuk kemi bërë gjë tjetër, veçse u kemi dhënë imunitet grupeve të trafikantëve. Ju keni ndërtuar piramidat tuaja, por mos harroni që i keni bërë gropën të ardhmes së këtij vendi. Faleminderit!